



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### **RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

| Eksperti Shqyrtues     | Data e pranimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës     |
|------------------------|------------------------------|------------------------------|------------------|
| <b>Fatmir Krasniqi</b> | <b>08.08.2025</b>            | <b>13.08.2025</b>            | <b>2025/0746</b> |

#### **BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT**

Me datën: 06.08.2025, OE “ARM ENERGY GROUP SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0746, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku për Lot 1 ka rekomanduar OE “LIMIII” SH.P.K., vlera e ofertës 38,975.90€ dhe Lot 2 ka rekomanduar për kontratë OE “Çlirim Berisha” B.L., vlera e ofertës 16,600.00€, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me dru per ngrohje” me nr. të prokurimit: "KM653-25-4820-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E KAMENICËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00€. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

#### **DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE**

Ligji me nr. 04/L-042 për Prokurim Publik i amandamentuar · Neni 1 - Qëllimi · Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti · Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi · Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale · Neni 108A i LPP · Nenet 61.1, 61.3 dhe 63.2 i RREGULLORES PËR PROKURIMIN PUBLIK

#### **KRITERET PËR VLERËSIM**

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i vlerësimit është ngrit në platëformën elektronike e-prokurimi me dt 24.07.2025

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ARM ENERGY GROUP SH.P.K.**

### Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – AK- Komuna e Kamenicës, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar 100,000.00€.

AK me dt. 29.05.2025 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 18.06.2025 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar gjashtëmbëdhjetë (16) operator ekonomik në mesin e tyre edhe OE ankues

Autoriteti Kontraktues – AK- Komuna e Kamenicës me dt. 24.07.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për kontratë Lot 1 ka rekomanduar OE “**LIMIII**” SH.P.K., vlera e ofertës 38,975.90€ dhe Lot 2 ka rekomanduar për kontratë OE “**Çlirim Berisha**” B.I., vlera e ofertës 16,600.00€. Ndërsa ofertën e OE ankues komisioni i ri- vlerësimit e ka vlerësuar si ofertë e

përgjegjshme por e pasuksesshme.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt. 29.07.2025 brenda afatit ligjor. Vlen të ceket fakti se AK, fare nuk e kishte “pezulluar” aktivitetin e prokurimit dhe poashtu nuk e kishte njoftuar OE ankues se do te vonohet me nxjerrjen e vendimit mbi shqyrtimin e pretendimeve ankimore. OE në mungesë te përgjigjes nga ana e AK me dt 06.08.2025 ka parashtruar ankese pranë OSHP-së, kurse AK po atë ditë me dt. 06.08.2025 ne ora 15:55 ka ngritur në platëformën elektronike e-prokurimi vendim mbi aprovimin e kërkesës per ri-shqyrtim te dorezuar nga OE me arsyetimin se kërkesa për ri-shqyrtim është pjesërisht e bazuar dhe vendos që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Për ta çartësuar këtë, me datë 12.08.2025 kam kërkuar sqarime shitesë nga AK, lidhur me atë se a është anuluar njoftimi mbi vendimin e AK-së, pas aprovimit të kërkeses për ri-shqyrtim dhe se lënda është kthyer në ri-vlerësim dhe se per vonesë te nxjerrjes se vendimit nuk ka qenë i njoftuar OE ankues. AK, përmes sqarimeve të ofruara në platëformën e-prokurimi me dt 12.08.2025 ka konfirmuar se Kërkesa për ri-shqyrtim e OE ankues është aprovuar si pjesërisht e bazuar dhe se tani komisioni për ri-vlerësim është duke bërë ri-vlerësimin e ofertave për të eliminuar parregullsit e evidentuara në kërkesen për ri-shqyrtim nga ana e OE ankues dhe poashtu OE ankues nuk është njoftuar për vonesen e nxjerrjes së vendimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se, pas shqyrtimit të provave shkresore konstatojmë se, AK nuk ka vepruar në përputhje me pikat 2 dhe 6 të nenit 108 A të LPP-se, pasi që nuk e kishte pezulluar fare aktivitetin e prokurimit dhe njëkohësisht nuk e ka njoftuar OE per vonesen e nxjerrjes së vendimit. AK, pas dorëzimit të ankeses në OSHP, me dt. 06.08.2025 ka nxjerr vendim duke aprovuar si pjesërisht te bazuar Kërkesen për Ri-shqyrtim të OE ankues, duke e kthyer lënden e ri-vlerësim. Andaj vlerësojm se nje veprim i tillë i AK-së ka shkaktuar shkaktuar zvarritje te panevojshme të procedurës.

Si përfundim, vlerësojmë se ankesa e dorëzuar me dt. 06.08.2025 me numer 2025/0746 nga OE ankues ARM ENERGY GROUP SH.P. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull; “LOT -1- Furnizim me dru për ngrohje për Institucionet Arsimore” dhe LOT- 2- Furnizim me dru për ngrohje për QKMF-në me numër të prokurimit: KM653-25-4820-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)– Komuna e Kamenicës, është e bazuar, pa pasur nevoj te shtjellohen pretendimet ankimore veç e veç për faktin se AK, ka aprovuar Kërkesen për ri-shqyrtim te OE ankues dhe ka kthyer lënden në ri-vlerësim me ç’rast konsideroj se është përmbushur edhe petitumi i ankesës së parashtruar përmes të cilit OE ankues ka kërkuar nga Paneli që ankesa të aprovohet dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të AK-se

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ARM ENERGY GROUP SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje” me numër të prokurimit: “KM653-25-4820-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E KAMENICËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E KAMENICËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **ARM ENERGY GROUP SH.P.K.**

**Fatmir Krasniqi**

